

# Statistikat e transportit

## Shkurt 2020

**Tiranë, më 26 Mars 2020:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Shkurt 2020 është 360 mijë ton, duke u rritur 14,6 %, krahasuar me Shkurt 2019.

Në dymujorin e parë të 2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 688,9 mijë ton, duke u rritur me 12,5 %, krahasuar me dymujorin e parë të 2019.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin Shkurt 2020 është 3,0 milion ton-kilometër, duke u rritur me 5,7 %, krahasuar me Shkurt 2019.

Në dymujorin e parë të 2020, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 6,0 milion ton-kilometër, duke u rritur me 16,9 %, krahasuar me dymujorin e parë të 2019.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër**

Periudha	Me det /ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër /ton
Shkurt 2019	313,811	2,795	167,0
Shkurt 2020	359.554	2.953	178.8
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>14,6</b>	<b>5,7</b>	<b>7,1</b>
Janar-Shkurt 2019	612.471	5.173	365.0
Janar-Shkurt 2020	688.927	6.045	355.9
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>12,5</b>	<b>16,9</b>	<b>-2,5</b>

\* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Shkurt 2020, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 178,8 ton mallra, duke u rritur me 7,1 %, në krahasim me Shkurt 2019.

Në dymujorin e parë të 2020, me ajër janë transportuar 355,9 ton mallra duke u ulur 2,5 %, krahasuar me dymujorin e parë të 2019.

**Tab.2 Treguesit e transportit ajror**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve*	Numri i mbikalimeve*
Shkurt 2019	16	1.690	8.637
Shkurt 2020	16	(...)	(...)
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>0,0</b>	(...)	(...)
Janar- Shkurt 2019	16	3.667	17.945
Janar- Shkurt 2020	16	(...)	(...)
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>0,0</b>	(...)	(...)

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

\* **Shënim:** Të dhënat mbi "Numrin e fluturimeve" dhe "Numrin e mbikalimeve" për muajin Shkurt 2020 mungojnë, por do të vihen në dispozicion në muajt në vazhdim.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Shkurt 2020 është 39.681 pasagjerë. Krahasuar me Shkurt 2019, ky tregues është rritur 12,9 %. Në dymujorin e parë të 2020, kanë udhëtuar me linjë detare 109.604 pasagjerë, duke u rritur me 7,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në muajin Shkurt 2020, transporti ajror i pasagjerëve zë 83,0 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në dymujorin e parë të 2020 është 439.400 pasagjerë duke u rritur me 10,3 %, krahasuar me dymujorin e parë të 2019.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Shkurt 2019	2.231	35.159	176.185
Shkurt 2020	64	39.681	193.720
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-97,1</b>	<b>12,9</b>	<b>10,0</b>
Janar- Shkurt 2019	5.227	101.730	398.298
Janar- Shkurt 2020	64	109.604	439.400
<b>Ndryshimi vjetor (%)</b>	<b>-98,8</b>	<b>7,7</b>	<b>10,3</b>

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

### **Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit**

Në Shkurt 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 75,9 mld lekë dhe 53,4 % e tyre u transportua me det.

Në dymujorin e parë të vitit 2020, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 140,8 mld lekë dhe 54,9 % e tyre u transportua me det.

**Tab. 4 Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit**


Mënyra e transportit	Eksport (mln lekë)				Import (mln lekë)			
	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.-Shk. 2019	Jan.-Shk. 2020	Shkurt 2019	Shkurt 2020	Jan.-Shk. 2019	Jan.-Shk. 2020
Transport detar	13.899	15.329	28.298	29.755	22.837	25.206	43.999	47.614
Transport hekurudhor	1	0	2	0	223	480	447	650
Transport rrugor	8.298	8.415	15.369	16.342	21.213	22.322	37.620	39.766
Transport ajror	72	153	139	238	1.594	1.482	3.106	2.733
Të tjera	341	420	652	994	3.970	2.107	6.754	2.740

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

### Eksportet e mallrave

Në Shkurt 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 63,0 %, me rrugë 34,6 % dhe me ajër 0,6 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur me 1,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Në dymujorin e parë të 2020, mallrat e eksportuara me det zënë 62,9 %, me rrugë 34,5 % dhe me ajër 0,5 %. Në dymujorin e parë të vitit 2020, mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2020**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

### Importet e mallrave


Në Shkurt 2020, mallrat e importuara me det zënë 48,9 %, me rrugë 43,3 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Shkurt 2020 janë rritur me 5,2 % krahasuar me Shkurt 2019.

Në dymujorin e parë të 2020, mallrat e importuara me det zënë 50,9 %, me rrugë 42,5 % dhe me ajër 2,9 %.

Në dymujorin e parë të 2020, mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 5,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

**Fig. 2** Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Shkurt 2020



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritjet të INSTAT

# Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Përkufizime

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet** janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet** janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007)** është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).*

## Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash